



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 28.02.2023

Nr: 17

Ora: 12:45

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR.06 dhe NR.09, DATË 17.02.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 28.02.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

OBJEKT: Vendosja e sanksionit administrativ ndaj zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat;

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kuadër të procedurave për mbikëqyrjen e procesit të raportimeve për veprimtaritë publike të institucioneve shtetërore, ka konstatuar se nga ana e Bashkisë Berat janë kryer një numër raportimesh të veprimtarive publike në shkelje të afatit ligjor prej 5 ditësh, që përcakton pika 2, e nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat, i cili është personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për institucionin, Bashkia Berat.
3. Në përfundim të hetimit administrativ i cili i përket periudhës së monitorimit 20 - 23 janar 2023, Komisioneri ka konstatuar 2 raportime që janë kryer në një afat më të ngushtë se afati minimal ligjor dhe ka vendosur t'i kërkojë KAS-it marrjen e masës administrative gjobë në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë ndaj zj. Arisa Toska, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor, nëpërmjet kërkesës nr. 06, datë 17.02.2023.
4. Gjithashtu, në përfundim të hetimit administrativ i cili i përket periudhës së monitorimit 24 janar - 2 shkurt 2023, Komisioneri ka konstatuar 5 raportime (të tjera) të kryera në një afat më të ngushtë se afati minimal ligjor dhe ka vendosur t'i kërkojë KAS-it marrjen e masës administrative gjobë në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë ndaj zj. Arisa Toska, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor, nëpërmjet kërkesës nr. 09, datë 17.02.2023.
5. KAS-i caktoi me short anëtarin Elvis Çefa relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 06, datë 17.02.2023 të Komisionerit dhe në seancën e shqyrtimit paraprak të datës 27.02.2023 vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës dhe caktoi si datë për shqyrtimin e saj datën 28.02.2023. KAS-i caktoi me short anëtarin Elvin Lako relator për shqyrtimin e kërkesës nr.09, datë 17.02.2023 të Komisionerit dhe në seancën e shqyrtimit paraprak të datës 27.02.2023 vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës dhe caktoi si datë për shqyrtimin e saj datën 28.02.2023.
6. KAS-i në datën 27.02.2023 me vendimin nr. 15 vendosi bashkimin e kërkesave nr. 06 dhe nr. 09, me relator z.Elvis Çefa.
7. Seanca e datës 28.02.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Sekretari i

Përgjithshëm i Bashkisë Berat, megjithëse ishte njoftuar rregullisht, nuk mori pjesë në seancë.

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 06, datë 17.02.2023 të Komisionerit;
- Kërkesën nr. 09, datë 17.02.2023 të Komisionerit;
- Vendimin e Komisionerit nr. 40, datë 08.02.2023 “Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Berat, për periudhën 20 Janar – 23 Janar 2023”;
- Vendimin e Komisionerit nr. 51, datë 10.02.2023 “Për shqyrtimin administrative të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Berat, për periudhën 24 janar-2 shkurt 2023”
- Ekstraktin e raportimeve nga ndërfaqja e raportimeve e KQZ-së për veprimtaritë:
 1. Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.1.2023,
 2. Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.1.2023,
 3. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.1.2023,
 4. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
 5. Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
 6. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
 7. Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 1.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 5.2.2023.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Kërkesat me nr. 06 dhe nr. 09 kanë identifikuar gjithsej 7 raste raportimesh nga Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Berat të kryera në shkelje të afatit 5 ditor që parashikon pika 2, e nenit 92 të kodit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor në pikën e sipërcituar kërkon që *“raportimi ... të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë”*, duke përbërë kështu një mekanizëm parandalues për të evituar keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe mosrespektimin e barazisë së armëve në procesin zgjedhor. Në këtë mënyrë KQZ ka mundësinë që të ndërhyjë në kohë, sipas parashikimeve në dispozitat e tjera të nenit 92, për të moslejuar zhvillimin e veprimtarisë, nëse ajo është e në kushtet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore. Mosrespektimi i afatit 5 ditor nga data e planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë objekt raportimi, e vendos KQZ-në në pamundësi serioze për të luajtur rolin e saj parandalues (kur është rasti), duke e bërë në këtë mënyrë mekanizmin në fjalë të paaplikueshëm.
2. KAS vlerëson se rastet e proceduara për vendosjen e sanksionit administrativ përbëjnë veprimtari tipike publike dhe janë raportuar si të tilla (të hapura për publikun, me praninë e medias) nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Berat, për shkak se kanë qenë të hapura për prezencën e publikut dhe medias si edhe me pjesëmarrjen e titullarit të institucionit, kryetarit të Bashkisë Berat. Ato përbëjnë veprimtari publike edhe për faktin se publiku i targetuar ka qenë komuniteti tregëtar i Bashkisë Berat, si publik votues. Në këndvështrim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, veprimtaritë janë publike kur ato *“...janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*. Veprimtaritë objekt shqyrtimi janë të organizuara nga vetë institucioni pra, nga personat që e përfaqësojnë zyrtarisht atë (institucionin) dhe që veprojnë në emër të tij.
3. Raportimi është bërë në një afat më të shkurtër se 5 ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara, me të drejtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar brenda afatit të përcaktuar.

4. Aktivitetet janë titulluar “Këshillim” dhe “Inspektim/Kontroll” dhe kanë konsistuar kryesisht në zhvillimin e takimeve me disa biznese për t’u njohur me shqetësimet dhe problematikat e tyre në lidhje me punimet që zhvillohen në atë zonë. KAS vlerëson se në rastin konkret, në vendosjen e sanksionit administrativ, për KQZ-në nuk është determinant fakti nëse qëllimi i veprimtarive objekt shqyrtimi ka qenë tërheqja e votuesve apo përcjellja e mesazheve elektorale në këto veprimtari, duke keqpërdorur burimet shtetërore. Në rastin konkret, arsyeja e sanksionit administrativ ka të bëjë vetëm me mosrespektimin e afatit 5 ditor, pa qenë i nevojshëm vlerësimi në themel i qëllimit të veprimtarive të raportuara.
5. Rastet e raportuara në shkelje të afatit 5 ditor përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë i përkasin dy periudhave të ndryshme dhe për këtë arsye Komisioneri nëpërmjet dy kërkesave të ndryshme ka kërkuar vendosje sanksioni administrativ të vecantë gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për secilën nga këto periudha, pra në total sanksioni i propozuar është gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë.
6. KAS-i çmon se Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Berat është “person i ngarkuar me detyra”, në kuptim të pikës 1, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, për shkak se ai është personi i caktuar përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike. Për pasojë, kërkesat e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ për raportim në mosrespektim të afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor për veprimtaritë:
- Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.1.2023,
 - Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.1.2023,
 - Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.1.2023,
 - Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
 - Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
 - Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,

– Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 1.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 5.2.2023.

janë të bazuara ligjërisht. Shkelja e afatit 5 ditor që përcakton pika 2, e nenit 92 përbën shkelje të Kodit në të gjitha rastet e parashikuara në dy kërkesat e paraqitura nga Komisioneri, i cili me të drejtë ka konstatuar se Bashkia Berat është përsëritëse në shkeljen e detyrimit ligjor të raportimit brenda afatit të përcaktuar të veprimtarive publike, prandaj KAS-i çmon se ato duhet të pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS, në seancën e datës 28.02.2023

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesave të Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat, për shkeljen e afatit sipas pikës 2, të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar